

Dr. Jusuf Kardavi

*Muslimanja
e së nesërtes*





Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

MUSLIMANJA E SË NESËRMES

Dr. Jusuf Kardavi

Botuar nga: Botues privat

© Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë përkthyesit Bajram (Benjamin) Idrizi

PARATHËNIE

Deri më tani, lexuesi ynë ka patur rast që nëpërmjet shkrimeve të ndryshme të njoftohet me rolin dhe pozitën e gruas në Islam, me obligimet dhe të drejtat e saj që i gëzon si dhe me çështje të tjera në raportin Islami – grua. Edhe ky punim i shkurtër i dr. Jusuf Kardavit, i titulluar *Muslimanja e nesërme*, ofron të dhëna dhe njohuri lidhur me raportin e sipërpërmendur.

Nga vetë titulli i këtij libërthi, mund të kuptohet se nga cili aspekt shtjellohen çështja dhe problematika e muslimanes. Ajo që e ofron ky libër i shkurtër është një përshkrim indikativ i gjendjes reale të femrës sonë, i përcjellë me udhëzime për të nesërmen, të ilustruara me shembuj nga koha e gjeneratës së parë muslimane. Pra, muslimanja për të patur lumturi dhe prosperitet në jetë si dhe për ta gjetur vendin dhe rolin e saj në shoqëri, medoemos duhet të bëjë përpjekje që të lirohet nga ndikimi i dy rrymave të cilat e kanë kuplur atë sot: rryma që shpie kah fanatizmi, shtrëngimi, kah mbyllja absolute e femrës dhe rryma që shpie kah liria e pakufishme, “liri” që në mënyrë të verbër imitohet nga femra e Perëndimit.

Mjerisht, këto dy rrugë të papëlqyeshme janë më se të pranishme ndër femrën muslimane të trevave tona. Pra, muslimanen tonë e gjejmë në dy skajshmëri që aspak nuk kanë të bëjnë me Islam: në njërin anë të mbyllur midis katër mureve, të paarsimuar, të injoruar, pa të drejtë për zgjedhjen e bashkëshortit etj., ndërkaq në anën tjetër, të “përparuar”, të “modernizuar”, absolutisht të lirë që të bëjë një jetë të shfrenuar.

Shpresojmë se ky trajtim i dijetarit të njohur dr. Jusuf Kardavi, do ta japë kontributin dhe ndihmesën e vet dhe se do ta nxisë femrën muslimane, por jo vetëm atë, që të bëjë përpjekje të vazhdueshme që të lirohet nga kahet e gabuara të rrugëve të

sipërpërmendura, me qëllim që ta gjejë personalitetin e saj të vërtetë.

BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM

Të falënderoj vetëm ty o Allah, përshëndes dhe e nderoj të dërguarin Tënd, familjen, shokët, thirrësit dhe udhërrëfyesit e sunnetit të tij deri në Ditën e Gjykimit.

Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, sepse Ti je Dhurues i Madh.

Zoti ynë, na mëso më të dobishmen, na bëj të dobishëm me ato që na mëson dhe na e shto diturinë.

Të falënderoj vetëm Ty, për çdo gjë, o Allah dhe kërkojmë mbrojtje dhe shpëtim prej Teje nga gjendja e banorëve të Zjarrit. Kërkojmë prej Allahut mbrojtje dhe shpëtim, nga dituria që nuk ka dobi, nga zemra që s'ka frikë, nga puna që s'ka vlerë dhe nga lutja që nuk pranohet nga ana e Tij.

Këtu do të flasim për muslimanen e së nesërmes, për atë muslimane për të cilën kam krijuar një vizion se si duhet të jetë ajo në të ardhmen.

MUSLIMANJA SOT – MES DY RRYMAVE TË GABUARA

Pse e zgjedha pikërisht temën *Muslimanja e së nesërmes*?

Për fat të keq muslimania bashkëkohore nuk është në nivelin e duhur të parimeve Islame, ashtu si duhet të jetë, por falenderojmë Allahun e Lartësuar që në shtetet Islame apo në përgjithësi në botën arabe, ka muslimane besimtare të denja, të

respektuara e të devotshme. Sot femrën muslimane e hasim ndërmjet dy rrymave kontradiktore dhe që të dyja të gabuara: ndërmjet rrymës që i mbështetet fanatizmit nga shtrëngimi dhe mbyllja e dyerve para syve të saj dhe rrymës tjetër që asaj tërësisht ia hap dyert e i jep liri absolute, i mundëson të veprojë çfarë të dëshirojë, të ndikohet prej gruas Perëndimore të cilën e imiton verbërisht; të imitojë ashtu siç imiton majmuni dhe të flasë ashtu siç flet papagalli. Mjerisht, që të dyja rrymat për muslimananen e vërtetë janë të gabuara.

Këto dy rryma i hasim praktikisht edhe sot e kësaj dite. Hasim në teprime e devijime. Shohim se si femra fejohe pa e parë fare të fejuarin e vet, nuk i mundësohet ta zgjedh atë që e dëshiron, kjo ndodh edhe me të fejuarin i cili nuk mund ta shohë të fejuarën gjerësa të vij nata e martesës dhe të befasohet me atë që mund të jetë e kundërta e asaj që e ka imagjinuar tërë kohën.

Nga ana tjetër ekziston edhe një shoqëri tjetër e zhvilluar dhe moderne, e cila lejon që i fejuari të takohet e të shoqërohet me të fejuarën, të ecin parqeve, të shkojnë në piknik, në kinema, në teatër e në vende të tjera ku mund ta kalojnë natën të lirë e pa shqetësime.

Pra, këto janë ato dy rryma që janë krejtësisht të gabuara dhe të kundërta njëra me tjetrën, njëra fanatike e tjetra që ofron liri absolute. Të dyja këto rryma nuk mund ta përfaqësojnë Islamin si fe.

E VËRTETA E HUMBUR

Feja Islame e ka lejuar femrën që ta shoh të fejuarin e saj. Po ashtu, e ka lejuar edhe mashkullin, madje edhe e ka urdhëruar që ta shohë të fejuarën e vet.

Transmetohet se si njëherë një njeri i është drejtuar Pejgamberit a.s. duke i thënë: “U fejova me një femër”! *“E ke parë atë”?* – e pyeti Pejgamberi a.s. “Jo” – iu tha ai. *“Atëherë shko e shikoje atë, sepse kjo ndikon që ju të keni një mirëkuptim të plotë ndërmjet”* – i tha Muhammedi a.s.

Gjithsesi gjejmë shembuj të panumërt që flasin për lidhjet mes burrit dhe gruas.

Nga ana tjetër, ka shumë meshkujt që gruan nuk e konsiderojnë si të rëndësishme, e mbyllin në shtëpi, nuk e lejojnë që të shprehin idetë dhe vizionet e tyre, nuk pranojnë që të marrin mendimet dhe pëlqimet e vajzave të tyre për t’u fejuar apo edhe për t’u martuar, edhe pse Pejgamberi a.s. thotë: *“Merrni mendimin e grave dhe vajzave tuaja”*, që do të thotë se e këshillon burrin për të kërkuar mendimin nga gruaja për të bijën, për shkak se ajo e njeh atë, e kupton, ia di fshehtësitë dhe dëshirat e saj. Pra, për fatin e të bijës konsultimi i burrit me gruan është i domosdoshëm.

Allahut xh.sh., në lidhje me konsultimin mes prindërve për gjirin e fëmijës thotë: “E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) të gjirit, kjo nuk është ndonjë mëkat për ta”¹. Megjithatë ka disa nga burrat që nuk konsultohen me gratë e tyre. Por edhe nëse konsultohen, në të shumtën e rasteve mendimi i gruas nënvlerësohet, do të thotë propozimi i saj nuk pranohet.

¹ Kur’ani: Bekare, 233

KONSULTIMI ME GRUAN

Për fat të keq, te disa është krijuar bindja “konsultoni dhe kundërshtoni ato”. Ndërsa këtë asnjëherë nuk e ka porositur i Dërguari i Allahut. Në Kur’an thuhet: "...pas një konsultimi dhe pëlqimi...!"². Pra, si është e mundur të ekzistojë një bindje e tillë, e cila bie në kundërshtim me fjalët e Allahut?!

Pas “Marrëveshjes së Hudejbies” rreth një çështjeje shumë të rëndësishme, Muhammedi a.s. pas një zemërimi që për një çast ia shkaktuan shokët e tij, shkoi dhe u konsultua me gruan e tij, Ummu Selemen. Në të vërtetë, pasi Muhammedi a.s. i kishte porositur shokët që pas Umres të kthehen në Medine të qethur dhe të zhveshur nga ihrami, askush nga ata nuk kishte vepruar sipas këtij urdhëri. Ndaj i zemëruar nga kjo Muhammedi a.s. iu ankua Ummu Selemes duke i treguar çfarë i ndodhi me shokët e tij: “*U shkatërruan njerëzit*”! Atëherë gruaja e tij, Ummu Seleme, i tha: “O i Dërguari i Zotit, dil para tyre dhe mos bisedo me asnjërin. Kërko një berber që të t’i qethë flokët, e pastaj zhvishe ihramin në prezencën e tyre”. Dhe Muhammedi a.s. veproi ashtu siç e këshilloi Ummu Seleme.

Pa dyshim që ky konsultim ndikoi te masa e njerëzve të cilët thanë: “Si është e mundur që të mos veprojmë ashtu siç veproi Pejgamberi ynë?” Pastaj të gjithë, vepruan ashtu siç veproi Muhammedi a.s. Ndërsa kjo ishte meritë e Ummu Selemes.

Pra, edhe gruaja ka të drejtë që të shprehë mendimin e saj, dhe ai duhet respektuar.

² Kur’ani: Bekare, 233

IMITIMI I VERBËR

Në kohë të sotme gjejmë atë lloj njeriu që është neglizhent ndaj gruas së tij, por edhe atë lloj njeriu që i jep gruas përgjegjësi e liri të plotë. Kështu, gruaja bëhet zot shtëpie e jo burri. Ajo gëzon liri veprimi të plotë, ndërsa burri nuk pyetet dhe nuk vendos për asgjë. Allahu xh.sh. nuk ka thënë se gratë duhet të jenë përgjegjëse për burrat, por ka thënë:

“Burrat janë përgjegjës për gratë”³.

Burri i cili në shtëpinë e tij nuk dëgjohet si dhe nuk i respektohet mendimi e urdhrat e tij, por për çdo gjë vendos gruaja, atëherë ai nuk mund të konsiderohet burrë.

Nga kjo kuptohet se kemi të bëjmë me një fanatizëm dhe neglizhencë. Ajo që dëshirojmë është që këtu të gjendet mesatarja mes fanatizmit dhe neglizhencës, e kjo mesatare është drejtësia me të cilën erdhi edhe vetë Feja Islame e cila e qartëson më së miri këtë dallim. Muslimania e drejtë është ajo e cila zbaton obligimet e saja me vendosmëri dhe njëkohësisht i kërkon të drejtat e veta, madje i zbaton obligimet para se t'i kërkojë ato të drejta.

Në kohën e sotme ekziston një ideologji që kërkon të drejtat para se të zbatojë obligimet. Sot, çdo njeri dëshiron të dijë se cilat janë të drejtat e tij, para se të dijë obligimet e veta.

Gruaja kërkon të drejta në arsim, të drejtën e punës, të drejtën për të votuar, për të kandiduar, pa pyetur një herë se ç'duhet të bëjë dhe cilat janë obligimet e saja!

Interesimi për të drejtat para obligimeve, për formalen para esenciales, dhënia e rëndësisë trupit para shpirtit, interesimi për

³ Kur'ani: Nisaë, 34

rrugë e jo për shtëpinë është bërë karakteristikë për gruan bashkëkohore. Kjo ndodh ngase jemi të ndikuar shumë nga bota Perëndimore, nga gratë per-ëndimore, por muslimania nuk mund ta imitojë gruan Perëndimore, sepse secila prej tyre posedon karakteristika të posaçme.

Gruaja perëndimore e ka natyrën, besimin dhe trashëgiminë e vet nga tradita frytdhënëse, por edhe ajo muslimane e ka civilizimin e vet, traditën dhe besimin që është specifike e jona. Prandaj muslimania nuk duhet të imitojë gruan e Perëndimit apo atë të Amerikës.

Gruaja në vendet joislame punon e shoqëruar me meshkujt. Ajo vepron kështu jo me vullnet, por sepse ka qenë dhe është e detyruar, e jo e lirë për të zgjedhur... Ajo vepron kështu, sepse në të kundërtën do ta shkatërronte vetveten, do të vdiste urie, sepse për të nuk ka kush të përkujdeset e të shpenzojë. Për të nuk përkujdesen dhe nuk shpenzojnë as babai, as vëllai, e askush tjetër.

E NË ISLAM NUK ËSHTË KËSHTU ...

Gruaja në Islam është baza kryesore. Sipas rregullave të shariatit ajo është e siguruar dhe e liruar nga shpenzimet, sepse për të kujdeset bashkëshorti dhe ajo është nën mbikqyrjen e tij. Kur është vajzë ajo është e siguruar nga babai, nëse është motër nga vëllai, nëse është nënë nga i biri. Ajo është e siguruar, sepse këtë ia garanton ligji i sistemit për shpenzime sipas dispozitave të Sheriatit⁴.

Profesori ynë i nderuar, dr. Muhammed Jusuf Musa, Zoti e mëshiroftë, gjatë kohës që mbronte doktoratën në Paris,

⁴ Sheriat: Legjislacioni i fesë islame

shkruante në librin e tij *Islami dhe nevojat e njeriut për të*, edhe një rast shumë interesant, ku thotë: *“Jetonim në një shtëpi ku na shërbente një femër franceze. Nga sjelljet dhe karakteri i saj kuptohej se rridhte prej një familje e ndershme e autoritare. Nuk ishte nga ato femra që e ngacmojnë epshin, nuk ishte lavire e as prej atyre femrave që reklamojnë trupin e tyre nëpër lokale të caktuara. Ishte një vajzë që e kryente punën me nder dhe respekt. Për këtë vajzë e pyetëm zonjën e shtëpisë ku banonim, e cila na tha:*

“A e njihni filanin, atë tregtarin me famë?”.

“Po”- i thamë.

Pastaj zonja na tregoi se ai ishte xhaxhai i saj, pra, vëllai i babait të saj.

“Si është e mundur të lejojë që vajza e vëllait të tij të shërbejë në shtëpi të huaj?” – pyetëm ne. “Kjo vajzë duhet të ankohet në gjyq dhe të kërkojë që për nevoja të veta jetësore ta ndihmojë xhaxhai i saj, e jo të punojë shtëpive të huaja”.

Atëherë zonja e shtëpisë duke buzëqeshur na tha:

“Cili gjyq do të gjykonte për të? Pse, te ju ekzistojnë rregulla të tilla?”.

“Po - i thamë.- Ne kemi një sistem të tillë që çdo vajzë si kjo, do të kishte mundur ta ngrejë zërin e protestës kundër xhaxhait të vet dhe ta detyrojë atë që të bëhet mbikëqyrës i saj, të jetë siguri për nevojat e saj të përditshme”.

“Sikur ky sistem të sundonte ndër ne, asnjëherë nuk do të ishte parë ai varg femrash, të cilat që nga mëngjesi e deri në mbrëmje punojnë nëpër fabrika, tregje e nëpër kompani të ndryshme. Ato janë të shtrënguara të punojnë kështu, sepse nuk mund të gjejnë njerëz që do t'i financojnë dhe kujdesen për to materialisht” – përfundoi zonja e shtëpisë. Dhe ne kuptuam se këta njerëz kanë

një kulturë, një traditë dhe dispozita të posaqme.”

Nuk ka asnjë pengesë që femra të punojë në qoftë se është e nevojshme, apo në rast se shoqëria ka nevojë për punën e saj: si mësuese, edukatore, mjeke etj. Ekzistojnë disa lloje të punës që mund t’i kryejnë femrat, punë këto që i përshtaten natyrës së saj.

Kjo të bën të kuptosh se jemi të hutuar, sepse imitojmë verbërisht.

GRUAJA MUSLIMANE MES DY KOHËRAVE TË KALUARA

Nuk ka dyshim se femra jonë muslimane dëshiron të bëhet plotësisht si ato të Perëndimit, edhe pse Lindja është Lindje e Perëndimi – Perëndim. Por, shpresojmë se femra muslimane nesër (me dëshirën e Allahut xh.sh.) do të vetëdijësohet dhe se nuk do ta ketë atë kompleks të imitimit, se do t’i kthehet besimit të plotë dhe bindjeve të shëndosha. Shpresojmë se së shpejti muslimanja të kaluarën do ta shikojë me një sy tjetër. Se të djeshmen, jo të djeshmen e afërt por atë të largëtën, të djeshmen e shokëve të Pejgamberit a.s. dhe të gjeneratës së Tij, do ta shikojë me një shikim të përhershëm e lakmitar.

E DJESHMJA E AFËRME

Femrën muslimane, e karakterizojnë, nëse mund të themi, dy të djeshme: e djeshmja e afërt dhe ajo e largët. Të ndalemi këtu dhe ta portretizojmë muslimanen e të djeshmes së afërt. Gjatë kësaj të djeshmeje femrën e karakterizonte prapambetja. Shekujt e prapambeturisë i impononin asaj një padrejtësi, një injorancë që e izolonte tërësisht.

Gjatë kësaj kohe muslimania ishte e izoluar nga jeta, feja dhe bota. Ajo gjendej shumë larg xhamive që janë rrugë udhëzuese për në fe dhe në jetë. Teologët juristë në kohët e mëparshme thonin: “Me të vërtetë koha ka marrë tatëpjetën, është koha e shpifjeve, andaj edhe vet paraqitja e gruas në ambiente të ndryshme shkakton shpifje”! Këtu qëndron shkaku i mendimeve të tyre se gruaja, e sidomos femra e re, nuk guxon të shkojë në xhami! I lejohet vajtja në xhami vetëm të moshuarave! Për këtë shkak, burri ka qenë i obliguar që ta mësojë femrën, e babai ta mësojë vajzën e tij nëse është ende e pamartuar. Ndërsa një gjë e tillë nuk kishte rezultat, sepse ska mundësi që babai ta mësojë vajzën, kur edhe vetë ai, baba, kishte nevojë ta mësojë dikush. Gjëja e humbur nuk sjellë asgjë! As babai, as vëllai, as burri nuk kanë pasur mundësi ta mësojnë gruan. Pra, femrës muslimane iu ndalua të marrë pjesë nëpër xhamia ku do të ndiqte ligjërata, këshilla e fjalime etj.. Ajo ishte e izoluar dhe në injorancë të thellë, duke mos i njohur obligimet e veta ndaj burrit, ndaj fëmijëve që rriteshin, jo me atë edukatë që e kërkon dhe që e urdhëron Islami. Për shkak të padituriës nëna muslimane ka zhvilluar te fëmijët e saj atë ndjenjë frike (stresi), e cila i është shtuar përmes rrëfimeve të saj për gogolin dhe kafshë të tjera. Tërë kohën ka kaluar duke i treguar fëmijës ngjarje të frikshme. Mjerisht tek ato edhe sot e kësaj dite vërehen gjurmë të këtij izolimi.

Femra e shekullit tonë ka filluar të dalë nga shtëpia dhe të shkojë në shkollë, në universitet, në treg, në punë, në kinema e në vende të ndryshme, por vendi i vetëm ku nuk ka shkuar ashtu siç duhet është xhamia!

- Përse gruaja nuk shkon në xhami?
- Përse nuk përgatiten ligjërata të posaqme për femra?
- Përse nuk paraqitet në mënyrë kolektive në namazin e xhumasë dhe në namazet e përditshme?

E, femra në kohën e Lajmëtari fisnik a.s. është paraqitur në namazet kolektive, rreshtat e parë kanë qenë të meshkujve, e të fundit të femrave. Femrat kanë hyrë dhe kanë dalë nga e njëjta hyrje së bashku me burrat. Kështu është vepruar për një kohë derisa një ditë Muhammedi a.s. u tha shokëve të vet: *“Ta lëmë këtë hyrje për gratë”*, duke aluduar në njërën nga hyrjet e xhamisë së bekuar. Ibn Omeri r.a. thotë: “Që atëherë nuk kam hyrë kurrë brenda në xhami nga kjo derë”! Kjo hyrje që gjendet në Xhaminë e Pejgamberit a.s., ende quhet hyrja e grave.

Në shekujt e prapambetorisë, për shkak të izolimit dhe injorancës së rëndë gruaja jo vetëm që nuk i ka kryer obligimet shtëpiake, obligimet ndaj fëmijëve, ndaj burrit, por ajo as që dinte t’i kryejë obligimet edhe ndaj Zotit të vet. Madje, gjatë kohës së injorancës femra muslimane është larguar nga namazi, nga obligimi i përditshëm që është shtyllë e fesë dhe kufi midis Islamit dhe kufrit.

Kështu që nuk dëshirojmë që t’i rikthejmë shekujt e injorancës dhe paditurisë, e as të vazhdojmë në dekadencë, por dëshirojmë që muslimania e sotme të ketë shembull muslimanet e para nga gjeneratat e arta, të ecë me kohën duke mos lënë anash për anjë moment obligimet veta. Të njohë obligimet e veta ndaj Allahut

xh.sh. dhe t'i zbatoj ato me devotshmëri, t'i ruaj kohët e namazit, të agjëroj, të ruaj nderin dhe karakterin e saj, të respektoj burrin, dhe të përpiqet maksimalisht në forcimin e besimit dhe ta ndjek këtë rrugë të drejtë duke qenë e bindur në shpërbilimin dhe të mirat nga Allahu në këtë botë dhe në ahiret.

E DJESHMJA E LARGËT

Në kohën e Muhammedit a.s. gruaja gëzonte të drejtën që të shkonte te ai, për ta pyetur madje edhe për punët personale të saj. Aisheja r.a. thotë: “I mëshiroftë Allahu gratë e ensarëve (medinaset), që as turpi nuk i ndalonte për ta mësuar sa më thellë Fenë Islame. Ato pyetnin edhe për punët më sekrete mes burrit dhe gruas. E bënë këtë meqë e dinin fort mirë se në fe nuk ka turp në shpjegime dhe ishin tejet të interesuara që t'i zbatojnë të gjitha ato urdhra e rregulla të porositura ndaj Allahut xh.sh.”.

Pas zbritjes së fjalës së Allahut xh.sh. “Thuaju edhe besimtareve t'i ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos i zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le t'i vënë shamitë mbi kraharorin e tyre...”⁵ - Aisheja r.a. rrëfen se si gratë e ensarëve shkuan menjëherë për të gjetur shamia e për t'u mbuluar. “Dhe kur erdhën të mbuluara në namaz, kur hynë në xhami, mbi kokat e tyre dukej sikur po qëndronin shpezët”, - rrëfen Aisheja r.a. Kjo dëshmon atë se sa gratë e asaj kohe ishin të përpikta dhe të vendosura që t'i zbatonin të gjitha urdhrat e Allahut xh.sh. Gjithsesi, gruaja e asaj kohe ishte edhe mbështetja më e fortë e burrit.

Esmaja, vajza e Ebu Bekrit r.a., çdo ditë i ndihmonte burrit të vet, Zubejr ibn El-Avvamit, i cili posedonte tokë larg Medines.

⁵ Kur'ani: Nurë, 31

Esmaja për çdo ditë kalonte kilometra të tërë që t'ia dërgonte ushqimin të shoqit që punonte në arë. Një ditë, pasi e kreu këtë obligim, duke u kthyer për në shtëpi u takua me Pejgamberin a.s. i cili kur e pa ashtu të raskapitur e të lodhur, i ndihmoi që të hipte mbi kafshën e vet. Esmaja këtë rast ia tregoi Zubejrit. Atij iu dhimbs gruaja për shkak të punës së rëndë që po e kryente, porse kjo punë ishte obligim i saj për ta ndihmuar burrin e vet. Nga kjo fare lehtë mund të vijmë në përfundim se gruaja duhet të jetë pranë burrit jo vetëm në çastet e harmonisë por edhe në momentet e vështira.

Fatimeja, e bija e Resulullahut a.s., zonja e të gjitha grave të botës, ishte një punëtore e pashoqe, mbante pastërtinë e shtëpisë, përgatiste ushqim, gatuante bukë, por jo siç gatuhet sot me lehtësi, por në atë kohë së pari përgatitej gruri e pastaj buka. Kështu, një ditë derisa po përgatiste grurin për ta gatuar bukën, ndjeu dhembje të rëndë në duar, por megjithatë gatimin e bukës nuk e ndërpreu. Për dhembjen që e ndjente në duar i tregoi edhe Muhammedit a.s., prej të cilit kërkoi një shërbëtorë. Muhammedi a.s. e donte fort Fatimenë, madje njëherë për të pat thënë: *“Fatimeja është pjesë e imja, hidhërohem në atë që hidhërohet ajo”*. Pas ankesës për dhembjet në duar, Pejgamberi ﷺ. Fatimes iu drejtua me këto fjalë: *“Do ta tregoj ndihmën më të vlefshme se sa ajo që e kërkon ti. Kur do të përgatitesh për gjumë thuaj 33 Subhanallah, 33 Elham-dulil-lah dhe 33 Allahu ekber. Të përmendurit e Allahut për ty është më e vlefshme se sa ndihma e shërbëtores”*. Kjo e vërteton atë se të përmendurit e Allahut xh.sh. njeriut i jep fuqi shpirtërore për t'i kapërcyer vuajtjet e jetës, pra, ndihma duhet të kërkohet vetëm prej Allahut xh.sh.

Fatimeja i ofroi ndihmë të madhe bashkëshortit të saj Ali ibn Ebi Talibit. Në njëfarë dore ishte shërbëtorë e burrit të saj, ngase Aliu nuk kishte mundësi financiare për të paguar ndonjë shërbëtorë. Megjithatë ajo e kish marrë mbi vete obligimin që

vetëm me Aliun r.a. ta jetonte jetën, qoftë ajo e ëmbël apo e idhët. Kjo vendosmëri e saj do të thotë sinqeritet, respekt ndaj bashkëshortit.

Në kohën e gjeneratës së parë muslimanja ishte ndihma më e rëndësishme për burrin, por sot ndodh e kundërta! Gruaja nga burri kërkon para, veshmbathje luksoze dhe stoli. Dëshiron të ketë një pamje të jashtme që do ta dallonte nga gratë tjera. Për hir të bukurisë së saj e nxit burrin që të fitojë e të grumbullojë para në çfarëdo qoftë mënyre, qoftë ajo mënyrë hallall apo haram, e pastër apo e ndytë.

Në kohën e gjeneratës së artë, kur burri shkonte në punë apo në treg, gruaja i thoshte kështu: “Mjer për ty dhe për fitimin haram! Ne i përballojmë urisë por jo zjarrit dhe hidhërimit të Fuqplotit!” Këto fjalë burrin e dobët para haramit e kanë nxitur që të jetë i sinqertë, syçelë në llogarinë për pasojat para se të ngarkohet me haram.

Çfarë ishte qëndrimi i bashkëshortes kur burri i saj nisej për në luftë? S’domend se ajo posedonte një qëndrim burrëror, nxitës, që e përkrahte dhe i jepte vullnet burrit që merrte rrugën drejt luftës. Kur gruan e tillë e pyetnin se çka do të bënte ajo dhe familja e saj po qe se bashkëshorti i vritej dhe bëhej shehid në atë luftë, fjalët e saj ishin këto: “Unë e kam njohur burrin tim si njeri që sjell ushqim por jo edhe si furnizues. Nëse shkon ai, furnizuesi ynë do të mbetet po ai i përherëshmi - Allahu xh.sh.”! Muslimanja e nesërme duhet ta ketë shembull muslimanen e kohës së gjeneratës së artë, e cila përmes respektimit dhe adhurimit që e ka pasur ndaj Allahut xh.sh., vazhdimisht e ka ndihmuar burrin e saj, ta ketë si shembull pikërisht atë muslimane që me nder e me mburrje i kryente të gjitha obligimet që i dedikoheshin asaj. Nga muslimanja e nesërme kërkojmë që të jetë një grua e mirë, meqë begatia më e çmueshme në botë është pikërisht grua e mirë. Dëshirojmë që ajo të jetë nënë e

sinqertë që do t'i edukojë fëmijët në frymën e edukatës islame, që do t'ua forcojë moralin, do t'i mësojë për të mirat e Islamit, me qëllim që te ata ta shtojë ndjenjën e respektit, të dashurisë dhe adhurimit ndaj Allahut xh.sh. T'i mësojë ata që t'i urrejnë punët që e hidhërojnë Allahun xh.sh., t'i shmangë nga punët e ndyta e t'i nxisë kah punët e mira si dhe t'ua përkujtojë vazhdimisht Ditën e Gjykimit. Kjo është nëna e vërtetë muslimane! Në rastet kur paraqitet rreziku, kur jepet kushtrimi për luftë, të jetë nënë që do t'i nxisë fëmijët për pjesëmarrje në luftën e shenjtë, ashtu siç vepruan edhe nënat muslimane të kohës së gjeneratës së artë.

Dëshirojmë nëna si Hansaja e cila i përjetoj dy periudha: periudhën paraislame dhe atë pasislame. Në periudhën paraislame kur vdiq vëllai i saj Sahri, që e kishte vëlla prej babe, e pat tronditur rrethin me vajtimin e saj. Sa për ilustrim ta sjellim këtu një vajtim të saj:

Lindja e diellit ma përkujton Sabrin dhe e përkujtoj atë në çdo perëndim të diellit sikur të mos kishte vajtore tjera rreth meje që i vajtojnë vëllezërit e tyre, do ta mbysja veten...

Vargjet e vajtimit të saj janë të njohura. Por, pasi e pranoi Islamin ajo ndryshoi tërësisht. U bë një grua me moral e virtyte krejtësisht tjera. Në vete zbuloi qëllime dhe mendime të tjera, meqë u bë grua e fortë për nga imani.

Kur fëmijët e saj u nisën në Luftën e Kadisisë që shpërtheu në kohën e Umerit r.a., i këshilloi ata që të mos zbrapsen, të bëhen të qëndrueshëm dhe të synojnë që të bien shehidë në rrugën e Zotit të Plotfuqishëm. Me këto fjalë ajo në zemrat e bijve të saj shtoi bindjen dhe qëndrueshmërinë. Në luftë hynë katër djemtë e saj të cilët gjatë përleshjes me armikun njëri-tjetrit ia tërhiqnin vërejtjen për të mos i harruar porositë e nënës. Kësisoj, të

paluhatshëm në iman luftuan derisa Allahu xh.sh. i zgjodhi për shehidë. Që të katër ranë dëshmorë në rrugën e Allahut xh.sh. Ç'bëri nëna kur mori vesh për vdekjen e katër djemve të saj? A thua vajtoi, a i mëshonte vetes, a i griste rrobat, a bëri ashtu siç bënte në kohën e injorancës? Jo, sepse besimi i saj ishte shumë më i fortë se dhembja. Andaj, me këtë rast tha: “I falënderoj Zotit i cili më fisnikëroi me vdekjen e fëmijëve të mi në rrugën e Tij, e që i bëri shërim për mua në Ditën e Gjykimit”.

Vlen të përmendet edhe rasti i Esmā bint Ebu Bekrit. Kur djali i saj, Abdullahu, luftonte kundër fisit Umejje për shkak të hilafetit dhe u rrethua nga umevitët, ajo iu drejtua me këto fjalë: “O biri im, nëse je i drejtë mos i lejo këtij fisi që të luajë me kokën tënde”. Pastaj Abdullahu nënës së vet ia tha këto fjalë: “Oj nëna ime, unë frikohem se pasi të më mbysin do t’mi presin gjymtyrët për t’u tallur me trupin tim”. Ndërsa nëna ia ktheu: “Biri im, pasi të theret delja nuk ka dëm nëse ia rrjepin leshin”.

Ummu Fadli, gruaja e Abasit r.a., kur iu kumtua lajmi se njëri djalë i ka vdekur në filan vendin ndërsa tjetri në vendin tjetër, me një urti të thellë tha: “Ideali i tyre i lartë ata i largoi mes vete. Sikur të ishin njerëz pa ideal do të vdisnin në një vend, aty ku u lindën”.

Dhashtë Zoti që nëna e nesërme muslimane të jetë prej atyre që do t’u ngjasojnë nënave të gjeneratës së parë.

Dhashtë Zoti që muslimanja e nesërme të jetë muslimane që në mënyrë dinjitoze do t’i njohë jetën e fenë, e të mos jetë e izoluar dhe e paditur.

Dhashtë Zoti që ajo të shkojë në hap me kohën, por jo larg fesë së saj. Unë jam thellësisht i bindur se shumë shpejtë do të vijë koha kur muslimanja do të jetë e përgatitur në fe, kur do ta njohë kulturën, traditën, misionin e saj dhe kur do ta ndërtojë personalitetin e vet ashtu siç i ka hije. Atëherë, ajo me krenari

dhe guxim të pashoq do të shprehet me fjalët: “Unë jam muslimane”. Pra, ajo do të kuptojë se është pjesëtare e popullit të zgjedhur nga Allahuxh.sh..

Ajo do të jetë e vetëdijshme se nuk ka tjetër zot pos Allahut xh.sh., se pos Islamit nuk ka tjetër fe, se pos Kur'anit nuk ka libër tjetër dhe se Muhammedi a.s. është i dërguari i Allahut xh.sh. Ajo duhet ta ndjejë për obligim atë se duhet ta mbrojë Islamin, vlerat e tij, personalitetin islam si dhe traditat islame. Te ajo medoemos duhet të krijohet një bindje e këtitllë, e cila asaj i mundëson një jetë të lumtur. Medoemos duhet të dijë se kërkimi i diturisë është obligim (farz) për çdo musliman dhe muslimane, meqë Islami me të gjitha mjetet e lufton injorancën. Ata të cilët femrën e sollën në pozitë të injorancës, ata vetë ishin injorantë. Islami kërkon që edhe burri edhe gruaja të jenë të dijshtëm.

Ekzistojnë të dhëna të shumta që flasin për atë se si femrat muslimane në të kaluarën u kanë dhënë burrave fetva rreth shumë çështjeve islame. Nga ana tjetër, gjithashtu mësojmë se si në atë kohë burrat shkonin te nënat muslimane (gratë e Pejgamberit a.s.), si psh. te hazreti Aisheja r.a. apo te Ummu Seleme, për të kërkuar nga ato që t'ua transmetojnë hadithet e Pejgamberit a.s. si dhe për t'i konsultuar rreth shumë çështjeve islame. As'habët dhe tabiünët më të njohur shkonin te Aisheja r.a. dhe pa ngurrim e pyetnin rreth çështjeve të ndryshme islame. Këtë e dëshmojnë edhe librat e shumtë ku janë përmbledhur shpjegimet e saj. Imam Zerkeshiu në librin e tij “Përgjigjet e Aishes r.a. në pyetjet e as'habëve” thekson: “Ishte Aisheja ajo e cila iu përgjigj as'habëve duke u thënë se filani ka gabuar në këtë gjë e tjetri në këtë gjë...”. Të gjitha këto ua thoshte me plot burrëri.

Në shekujt e mëvonshëm gratë muslimane shpeshherë organizonin tubime shkencore nëpër vende të posaçme. Sekineja, vajza e Husejnit, kishte amfiteatër të vetin ku herë pas

here organizonte tubime të ndryshme shkencore. Thuhet se imam Shafi'iu, njëri nga katër themeluesit e medh'hebeve, shpeshherë merrte pjesë në tubimet e saj.

Shumë gra muslimane ishin edhe transmetuese të drejtpërdrejta të haditheve të Pejgamberit a.s., te të cilat vinin shumë burra për t'i mësuar dhe për ta vërtetuar autenticitetin e haditheve.

Hafëz ibn Haxher Askalani, njëri ndër komentuesit më të shquar të përmbledhjes së Buhariut, shpeshherë thoshte: “Një nga mësuesit e mi është filanja, e bija e filanit!”.

Njëri nga imamët hanefitë kishte një vajzë e cila jepte fetva ngjashëm sikurse babai i saj. Në letrën ku shkruhej fetvaja figuronte nënshkrimi i babait si dhe nënshkrimi i saj që e vërtetonte atë fetva. Këtë vajzë, ky imam e martoi me njërin nga nxënësit e tij, Alaudin Kasanin, i cili shquhej si dijetar i madh. El-Kasani shkroi një libër rreth fikhut hanefit, që njihet si komentim i zgjeruar i librit të mësuesit të tij, e për të cilin në atë kohë dijetarët thoshin: “E komentoj librin e mësuesit, vajzën e të cilit e mori për grua. Fetvatë që i jepte ajo i nënshkruante vetë por edhe burri i saj...”.

Për gra shumë të zgjuara dhe të ngritura në fusha të ndryshme shkencore flet edhe Ebu Hajani, i cili vazhdimisht i përmendë dhe i lavdëron në veprat e tij.

PLOTËSIMI MES GRUAS DHE BURRIT

Gruaja më parë në asnjë moment nuk ka qenë e izoluar pos në shekujt kur qe e përmbytur në prapambeturi dhe degjenerim.

Kur thuhet se gruaja duhet ta mbrojë personalitetin e vet islam, kjo nuk nënkupton atë se ajo duhet të izolohet nga jeta ose t'i cungohet ndonjë nga të drejtat që i takojnë.

Feja Islame, ngjashëm sikur burrin, e obligon edhe femrën që të mësojë e të pajiset me të gjitha dituritë e mundshme. “Pasha natën që me errësirë mbulon Gjithësinë. Pasha ditën kur ajo shkretë pëtinë. Pasha Atë që e krijoi mashkullin dhe femrën...”⁶.

Allahu xh.sh. ashtu siç e krijoi jetën që rrjedh me net e me ditë, ashtu i krijoi mashkullin e femrën për ta plotësuar njëri-tjetrin. Sikurse jeta që plotësohet me ditën e natën, ashtu plotësohen njëri me tjetrin edhe mashkulli dhe femra. Allahu xh.sh. thotë: “Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje – mashkull dhe femër – që ju ta përkujtoni madhësitë e Zotit”⁷.

Gruaja kurrë nuk mund të jetë kundër burrit e as armik i tij. Për këtë Allahu xh.sh. tha: “Zoti i tyre iu përgjigj lutjes së tyre e tha: Unë nuk ia humba mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër”⁸. Kjo do të thotë se burri është për gruan dhe gruaja për burrin. Jeta e tyre nuk do të kishte kurrfarë kuptimi pa njëri-tjetrin, kështu që gruaja nuk guxon të kalojë në armiqtë e ta sulmojë burrin, përkundrazi, ajo duhet ta plotësojë atë në çdo aspekt.

Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s. dhe e vendosi në xhennet, por pasi që të jetuarit vetë në xhennet nuk ka kuptim, atë e shoqëroi me një grua (hazreti Havën) që të jetojnë së bashku.

“O Adem, ti dhe bashkëshortja jote jetoni në xhennet”⁹. Po ashtu thotë: “Ai (Allahu) është Ai që ju krijoi prej një vete, e prej saj krijoi palën e saj për t’u qetësuar pranë saj...”¹⁰, me qëllim të plotësimit të vendbanimit.

Burri është krijuar për gruan dhe gruaja për burrin. Gruas nuk i

⁶ Kur’ani: Lejl, 1, 2, 3

⁷ Kur’ani: Dharijatë, 49

⁸ Kur’ani: Ali Imran, 195

⁹ Kur’ani: Bekare, 35

¹⁰ Kur’ani: A’rafë, 189

lejohej që qëllimi kryesor i saj të jetë kundërshtimi ndaj burrit. Pra, muslimanja e nesërme nuk guxon ta kundërshtojë burrin, ta kërkojë punën të cilën e punon burri, apo ta kërkojë rroben të cilën e vesh burri.

Mjerisht, në këtë fundshekull që po e jetojmë sikur janë përzier rolet dhe karakteret e këtyre dy krijesave të Zotit të plotfuqishëm. Gruaja gjithnjë e më tepër shpreh dëshirë për t'u bërë burrë, ndërsa i riu karakterizohet me gjeste femrash dhe sikur ta shton bindjen se ai gjithnjë e më tepër dëshiron të shndërrohet në tip femre.

Pra, burri me burrërinë dhe fuqinë e vet duhet të mbetet burrë, ndërsa gruaja me butësinë e saj të mbetet grua. Nëse burri e humb burrërinë e gruaja butësinë, do të humbin edhe kuptimi dhe vlera e vetë jetës. Për këtë shkak Pejgamberi a.s. nuk lejoi që burri të veshë rroba femrash e as femrën që të veshë rroba meshkujsh. E mallkoi mashkullin që i ngjason femrës dhe femrën që i ngjason mashkullit. Këtë e bëri me qëllim që secila gjini t'i mbrojë cilësitë dhe karakteristikat e veta ashtu siç ua fali Allahu xh.sh.

Unë mendoj se muslimanja e nesërme me gjithë shpirt do t'i qaset mbrojtjes së gjinisë së vet. Besoj se ajo nuk do ta imitojë burrërinë e mashkullit, por do ta ndihmojë atë, se do t'u qaset punëve që ia dikton natyra e saj; se do të punojë si mësuese, motër medicinale, si mjeke dhe se do t'i mjekojë motrat muslimane në vend që atë ta bëjë ndonjë mjek që mund të jetë edhe jomusliman, madje, të punojë edhe nëpër ato vende të posaçme ku shiten veshjet e brendshme të femrave.

NJË PASQYRË E GJENDJES NË SHTETET PERËNDIMORE

Jam thellë i bindur se muslimanja e nesërme do ta mbrojë personalitetin e saj dhe se me tërë qenien do ta kuptojë fenë dhe civilizimin e vet. Sot gjithnjë e më tepër po paraqiten muslimane, imituese të deridjeshme të kulturës perëndimore, që po vetëdijësohen e që po e kuptojnë se ky civilizim ka karakter shkatërrimtar. Pse femrat, tanimë të civilizuara, e urrejnë këtë civilizim? Sepse civilizimi i sotëm ka arritur shkallën më të lartë të materializmit. Perëndimi ka arritur që të krijojë armatim bërthamor për ta shkatërruar Gjithësinë, ka arritur që të shkelë në Hënë, por shtrohet pyetja se ku është karakteri dhe morali i këtij njeriu të civilizuar që vazhdimisht po shkakton vuajte dhe humbje shpirtërore. Marrëdhëniet ndërmjet babait dhe fëmijëve të tij, ndërmjet nënës dhe fëmijëve, ndërmjet fqinjve, sikur janë bërë një dukuri e parëndësishme. Në këtë shoqëri të civilizuar gruaja është e gatshme të blejë veturë dhe të paguajë për të mos e lindur fëmijën e dytë! Edhe pse fëmijët janë në marrëdhënie të punës, ata nuk shprehin interesim apo dhembje që të përkujdesen për prindërit e tyre, madje edhe nëse jetojnë në një bashkësi. Nëse jetojnë të ndarë nga prindërit, mund të kalojnë një kohë e gjatë e të mos takohen me njëri-tjetrin. Pikërisht për këtë shkak edhe lindi ideja për një festë, “Festën e nënës”, ditë kjo kur fëmijët takohen me nënat e tyre, me ç'rast u dhurojnë ndonjë dhuratë modeste.

S'do mend se prej periudhave më të vështira të jetës së njeriut është ajo e pleqërisë. Meqë shpeshherë baballarët mbesin vetë, ata pleqërinë e kalojnë të shoqëruar nga qentë me të cilët e kalojnë kohën e tyre.

Kam lexuar se, ta zëmë, në Francë ekzistojnë më tepër se shtatë milionë qenë të cilët ushqehen me biskota e çokollata. Në një

rast kur kryetari i shoqatës për përkujdesjen e kafshëve është pyetur për këtë numër kaq të madh të qenve, ai është përgjigjur: “Numri i qenve është kaq i madh, për shkak se njerëzit më me dëshirë e kanë pranuar shoqërimin me qentë se sa me njerëzit”!

Verën e kaluar isha në Amerikë ku dëgjova për një rast të çuditshëm. Flitej se njerëzit që banojnë nëpër ndërtesa shpeshherë ndiejnë një erë kundërmuese që del nga banesat. Kur ambienti ku jetojnë fillon të qelbet, atëherë kërkojnë ndihmë nga policët. Kur policët vijnë dhe i thyejnë dyert e banesave, tronditen thellë kur i shohin të vdekurit fillikat vetëm në dhomë. E kur fëmijët e tyre pyeten për këtë, ata vetëm i rrudhin krahët duke thënë: “Ne ia kemi siguruar jetën”!

Pastaj ka edhe shumë të atillë që pleqërinë e kalojnë nëpër shtëpitë e pleqve, pa i parë me vite e vite fëmijët apo nipat e mbesat e tyre.

Ja pra, ky është civilizimi që dikush turret për ta imituar. Ky është civilizimi për të cilin shkruajnë kritika e kritika duke e sulmuar ashpër e duke ia dëshiruar zhdukjen, ndërsa dikush nga ne joshet pas tij.

Jo, ne nuk kemi nevojë për një civilizim të tillë, sepse ne e kemi fenë që i plotëson të gjitha nevojat e jetës sonë dhe që bie ndesh me civilizimin perëndimor.

QËNDRIMI I FEMRËS NDAJ CIVILIZIMIT PERËNDIMOR

Pse njeriu importon gjëra dhe vlera të huaja kur ato i ka me bollëk dhe më të vlefshme e më me peshë në vendin e vet? Ç’është ajo që e posedon muslimani e që tjetërkush nuk e ka? Ç’është ajo që ka një peshë aq të madhe? Ajo është dhuratë prej

Allahut xh.sh. Është një gjë që nuk e prodhoi njeriu, por që e zbriti Krijuesi i Gjithësisë: “(kjo fe jona është) Ngjyrosje e Allahut, e kush ngjyros (me fe) më mirë se Allahu...”¹¹. “A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i Allahut?”¹².

Dashtë Zoti fuqiplotë që muslimanja e nesërme t’i qaset sa më shumë fesë dhe bazamenteve të saj, ta refuzojë e t’i shmanget imitimit të verbër, të mos lakmojë pas këtij civilizimi të huaj, të dijë ta dallojë të mirën nga e keqja e t’i pranojë të gjitha ato që i përshtaten e që ia lejon përkatësia e saj fetare islame. Pra, muslimanja e nesërme duhet të përqëndrohet në këto bazamente e jo në një imitim të verbër. Duhet t’i kryejë të gjitha obligimet e veta dhe t’i mbrojë të drejtat e saj. Nuk ka dyshim se muslimanja e nesërme më tepër duhet t’i përkushtohet thelbësorës e jo formales, duhet të jetë më e kujdesshme për shtëpinë se sa për rrugën. Ajo pikësëpari duhet t’i kushtojë rëndësi burrit dhe fëmijëve të saj, e jo ta ekspozojë trupin para njerëzve të huaj.

Dhashtë Zoti që femra muslimane ta ketë shembull muslimanen e gjeneratës së artë, e cila i kuptonte dhe i dinte të drejtat e saj, që i kryente të gjitha obligimet dhe që në thelb e njihte Fenë Islame. Muslimanja e nesërme duhet të jetë besimtare e denjë, e moralshme, e kuptueshme, misionare e dijetare. S’do mend se kjo do të ndikonte në ringjalljen e Fesë Islame, e cila me të madhe po pengohet për shkak të përpjekjeve për ta imituar tërësisht civilizimin perëndimor.

Kjo është dëshira jonë, një dëshirë për një etapë të re që do t’i shënonte dhe karakterizonte të gjitha sukseset e femrës muslimane. Dëshirojmë që të vijë një kohë sikur që ishte koha

¹¹ Kur’ani: Bekare, 138

¹² Kur’ani: Maide, 50

kur mirësia, respekti e dashuria ndaj gruas zbatoheshin pikërisht ashtu siç porositen Allahu xh.sh. përmes Kur'anit famëlart dhe Pejgamberi a.s. përmes Sunnetit të tij.

GRUAJA MES INJORANCËS DHE ISLAMIT

Islami në asnjë moment nuk i ka bërë padrejtësi gruas.

Në kohën e inyorancës burri e ka konsideruar gruan vetëm si objekt për plotësimin e kënaqësive të veta trupore dhe shpirtërore. Në atë kohë gruaja trajtohej ashtu siç trajtohej kafsha. Për shembull, djali e ka trashëguar gruan e babait të vet, ashtu siç i ka trashëguar dhentë dhe lopët e tij dhe me të sillej ashtu siç dëshironte vet. E martonte apo ia ndalonte martesën me ndonjë burrë tjetër. Në shtëpi e mbante përderisa ajo ta merrte pasurinë e saj.

Ndërsa këtë Islami e ndaloi rreptësisht.

Në shekujt e inyorancës gruaja nuk trashëgonte asgjë nga pasuria familjare, sepse, sipas traditës, trashëgimia i takonte vetëm atij që me armë në dorë luftonte për ta mbrojtur fisin e vet.

Islami ia garantoj të gjitha të drejtat gruas, e eliminoj atë sjellje jonjerëzore, atë shfrytëzim e urrejtje barbare të burrit ndaj gruas. Në atë kohë, siç e dimë, babai nuk i gëzohej lindjes së vajzës. Vajzën e lindur nuk e konsideronte për begati. Për këtë inyorancë të tmerrshme flet edhe vetë Kur'ani: “Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij i prishet dhe mbushet plot mllëf”¹³.

Islami e liroi gruan nga këto paragjykime primitive që kishin të bëjnë me të. Feja Islame gruan e konsideroj si një dhuratë prej dhuratave të Allahut xh.sh. “Vetëm i Allahut xh.sh. është

¹³ Kur'ani: Nahl, 58.

pushteti i qiejve e i tokës; Ai krijon çka të dojë; Ai i falë femra vetëm atij që do, e i falë vetëm meshkuj atij që do”¹⁴.

Islami gruas, qoftë ajo vajzë apo nënë, ia ka rritur vlerën. Sipas Islamit, babai me bijën e vet nuk guxon të sillet si me pasurinë, apo ta martojë me atë që dëshiron ai e përkundër dëshirës së saj. Në këtë rast vajzës i lejohet që lirisht ta shprehë mendimin e vet dhe, po qe se nuk pranon të martohet me atë që ia zgjedh babai, atëherë babai nuk guxon të veprojë kundër dëshirës së saj. Pra, Islami jo që nuk ia ka cinguar ndonjë të drejtë femrës porse asaj ia ka shtuar të drejtat, ia ka ngritur vlerën në çdo aspekt të jetës.

Transmetohet se si njëherë një vajzë e re erdhi te Muhammedi a.s. dhe i tha: “Baba im më martoi me një djalë, vetëm e vetëm që t’i ngrihet autoriteti”! Ndërsa Pejgamberi a.s. rreth kësaj çështjeje ia dha të drejtën vetë asaj për të vendosur. Pas kësaj vajza foli sërish: “Unë e pranoj atë që e bëri babai im, porse përmes pakënaqësisë sime desha që vajzave të tjera t’ua bëj me dije se baballarët nuk kanë të drejtë t’i martojnë ato me ata që dëshirojnë vetë ata”.

Muslimanja e nesërme e ka të patjetërsueshëm kthimin e saj në Islam, e qetë, me bindje e besim të paluhatshëm. Ajo duhet ta flakë nga vetja dhënien pas civilizimit perëndimor. Duhet të ketë një qëndrim të prerë që do t’i ndihmonte për ta dalluar të mirën nga e keqja, për ta pëlqyer atë që i konvenon asaj, ndërsa për ta larguar atë që asaj nuk i bën nder e respekt.

Me këtë rast vlen të theksojmë se çdo gjë e lakmueshme që gjendet në civilizimin perëndimor, të njëjtën e ka paraparë edhe Islami. Natyrisht, çdo gjë që është e dëmshme dhe e keqe në të, është luftuar dhe luftohet edhe nga vetë Islami. Ne nuk kemi nevojë që t’i importojmë vlerat dhe gjërat e huaja, e as që duhet

¹⁴ Kur’ani: Shuara, 49.

të kërkojmë prej të tjerëve, prej sofrave të të tjerëve, sepse Allahu xh.sh. sofrën tonë e begatoi me gjënë më të çmueshme për njeriun, me Islamin.

MUSLIMANJA E NESËRME

Motra ime e dashur!

Kjo është ajo që kërkohet prej muslimanes së nesërme. Prej saj kërkohet që ta njohë fenë dhe jetën e saj, të jetë prej atyre që vazhdimisht i kryejnë obligimet ndaj Allahut xh.sh., ndaj burrit e ndaj fëmijëve, ndaj shoqërisë e ndaj atdheut. Të bëhet një edukatore e palodhshme në edukimin e brezave të ardhshëm dhe në ringjalljen e vërtetë të Islamit.

Përmes ringjalljes dhe forcimit të Islamit, sidomos në Gadishullin Arab por edhe në të gjitha vendet ku jetojnë muslimanët dhe ku dëgjohet thirrja e ezanit nga minaret e xhamive, përmes mëshirës së Allahut do të kthjellet edhe vetëdija intelektuale, me ç'rast intelektualët do të jenë më konkretë e më të guximshëm, të cilët pastaj do të ndikojnë edhe në shtimin e pasurisë materiale dhe asaj shpirtërore. Nuk ka dyshim se lumturia shpirtërore vazhdimisht do të jetë në kulmin e vet.

Kjo është lumturia për të cilën Ummu Kulthumi, vajza e Aliut e bashkëshortja e Umerit r.a., fliste me kënaqësi pas një rasti kur Umeri r.a. i hidhëruar i kanosej se do ta bëjë të pikëlluar: “O burri im! Ti nuk mund të më bësh të pikëlluar, sepse lumturinë time unë e shoh në besimin tim, ndërsa besimi im është në zemrën time të cilën e mbizotëron, kush tjetër, pos Zotit tim”.

E lus Allahun xh.sh. që të na bëjë të sigurtë në fjalët dhe në veprat tona, të na nxisë për ta mësuar fenë tonë, ta orientojë

femrën muslimane drejt rrethit ku kalitet personaliteti islam, ta bëjë si muslimanet e gjeneratës së parë islame.

E përfundoj fjalën time duke kërkuar mëshirë nga Allahu xh.sh. për mua dhe për të gjithë ne.

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	2
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM.....	3
MUSLIMANJA SOT – MES DY RRYMAVE TË GABUARA.....	3
E VËRTETA E HUMBUR	5
KONSULTIMI ME GRUAN	6
IMITIMI I VERBËR	7
E NË ISLAM NUK ËSHTË KËSHTU	8
GRUAJA MUSLIMANE MES DY KOHËRAVE TË KALUARA	10
E DJESHMJA E AFËRME.....	11
E DJESHMJA E LARGËT	13
PLOTËSIMI MES GRUAS DHE BURRIT.....	19
NJË PASQYRË E GJENDJES NË SHTETET PERËNDIMORE....	22
QËNDRIMI I FEMRËS NDAJ CIVILIZIMIT PERËNDIMOR	23
GRUAJA MES INJORANCËS DHE ISLAMIT	25
MUSLIMANJA E NESËRME.....	27